

Në përgjigje të kërkesës për informacion lidhur me "Përfitim të Pagesës së Shpenzimeve të zbritëshme për mjekimin e fëmijës jashtë vendit", drejtuar Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, ju informojmë se:

Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor ushtron veprimtarinë e tij në zbatim dhe në përputhje të ligjit nr. 10 383 datë 24.02.2011 "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar. Në nenin 10 të këtij ligji parashikohen se sigurimi i detyrueshëm financon paketat e shërbimeve të sigurimit të detyrueshëm, ku përfshihen:

- vizitat, ekzaminimet dhe trajtimet mjekësore në qendrat e kujdesit shëndetësor parësor public dhe në spitalet publike;
- vizitat, ekzaminimet dhe trajtimet mjekësore në dhënës privat të kujdesit parësor dhe spitale private;
- barnat, produktet dhe trajtimet mjekësore nga dhënës të kontraktuar shërbimesh shëndetësore.

Fondi financon Listën e Barnave të Rimbursueshme të miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 489, datë 30.07.2021, "Për miratimin e Listës së Barnave që rimbursohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, dhe të masës së mbulimit të çmimit të tyre", të ndryshuar, sipas diagnozave duke respektuar kufizimet e saj dhe protokollat e përdorimit të barnave.

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 23, datë 18.01.2023 "Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor, për vitin 2023", Fondi lidh kontrata me dhënësit e shërbimit shëndetësor për financimin e paketave të shërbimeve shëndetësore spitalore, të ofruara prej tyre. Në këto përcaktohen edhe shërbimet shëndetësore, që do të mbulohen nga Fondi.

Me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 308, datë 21.05.2014, "Për miratimin e paketave të shërbimeve shëndetësore që do të financohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në shërbimin spitalor", i ndryshuar, Fondi lidh kontrata me institucionet shëndetësore publike dhe jo publike për financimin e këtyre paketave.